

VENDIM
Nr.265, datë 12.3.2009

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.343, DATË 27.3.2008 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E BURIMEVE DHE TË PROCEDURAVE TË
FINANCIMIT TË DËMEVE PASURORE, TË SHKAKTUARA NGA AKSIDENTI
TEKNOLOGJIK I GËRDECIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.343, datë 27.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje “...dhe në vendimin nr.120, datë 14.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.817, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerës së dëmeve, të shkaktuara në objektet, pronë private, si rrjedhojë e aksidentit teknologjik, të ndodhur në Gërdec, dhe të listave me emrat e individëve dhe personave fizikë e juridikë, që do të kompensohen, si rezultat i procesit të vlerësimit dhe të rivlerësimit””, në vlerën 26 093 453 (njëzet e gjashtë milionë e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) lekë, të debitorëve, të rezultuar nga procesi i rivlerësimit, me vendimin nr.817, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave, sipas tabelës përmbledhëse të rivlerësimeve.”.

2. Në pikën 2 të bëhen këto ndryshime:

i) në paragrafin e parë, shifra “...1572 milionë lekë...”, zëvendësohet me 2 619 192 273 (dy miliardë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

ii) Shifra “...150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë...”, e përmendur në shkronjën “a”, zëvendësohet me “... 481 093 210 (katërqind e tetëdhjetë e një milionë e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e dhjetë) lekë....”.

iii) Në shkronjën “b”, pas fjalëve “...Këshillit të Ministrave...” shtohen “...për vitin 2008...”

iv) Në shkronjën “c”, pas fjalëve “... i kontingjencës...” shtohen “... i vitit 2008...”

v) pas shkronjës “d” shtohen shkronjat “dh” e “e”, me këtë përmbajtje:

“dh) Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për vitin 2009, në masën 99 198 651 (nëntëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë.

e) Ngarkohet bashkia Vorë të ndjekë procedurat ligjore dhe të arkëtojë shumën 26 093 453 (njëzet e gjashtë milionë e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) lekë, (debitorët e rezultuar nga rivlerësimi), për llogari të Buxhetit të Shtetit.”.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha